



Koalicioni i Organizatave të Shoqërisë Civile për një Partneritet të Qeverisjes së Hapur-Shqipëri

Në datën 28 Mars, 2014 në Tiranë u mbajt Konferenca Rajonale “Partneriteti për Qeverisje të Hapur: Sfidat dhe Mundësitë 2014-2016. Kjo Konferencë u organizua në kuadër të procesit të konsultimit të Ministrisë së Inovacionit dhe Administratës Publike, në rolin e Koordinatorit Kombëtar të PQH në Shqipëri me aktorët e shoqërisë civile dhe sektorin privat, për hartimin e Planit të Veprimit për Qeverisje të Hapur 2014-2015.

Pjesëmarrës në këtë konferencë ishin përfaqësues të lartë të institucioneve publike shqiptare, organizata të shoqërisë civile, trupi diplomatik, ekspertë dhe organizata të shoqërisë civile nga rajoni i Ballkanit Perëndimor etj.

Rezultati kryesor i këtij aktiviteti ishte një paketë me rekomandime, e dalë nga Shoqëria Civile mbi angazhimet që duhet të ndërmerret Qeveria në Planin e Veprimit 2014-2015, si më poshtë:

REKOMANDIME:

- 1- Monitorimi i zyrave të informacionit, përmirësimi i informacionit që i ofrohet publikut si dhe shërbimi që iu ofrohet qytetarëve.
- 2- Përdorimi i teknologjisë për aftësimin e stafit pedagogjik në sistemin parashkollor, në shkollat fillore dhe në arsimin e misëm për të punuar me fëmijët me nevoja specifike.
- 3- Vendosja e sistemit elektronik të ankesave si dhe mekanizmave të kontrollit për shërbimet dhe standardet sociale që ofrohen në sistemin e arsimit të detyrueshëm (çerdhe + kopshte);
- 4- Vendosja e linkut “Shërbime” në portalet qeveritare dhe në faqet zyrtare institucionale si dhe bërja publike e listës së subjekteve të licencuara dhe të certifikuar për të ofruar shërbime.

- 5- Krijimi dhe bërja publike e një databaze me dënimet / masat ndëshkuese të marra për rastet e korrupsionit në administratë (në të gjitha nivelet) si dhe të vendimeve të sistemit gjyqësor) KLSH / ILKDP.
- 6- Bërja e transparencës, publikimi online i financimit dhe burimeve financiare të subjekteve politike;
- 7- Transparence persa i perket financave te institucioneve publike, te pasqyrohen dhe te behen publike per palet e interesuara, mundesisht ne faqet e tyre web.
- 8- Të vazhdohet angazhimi i ndërmarrë në planin 2012-2013 mbi transparencën e kompanive që punojnë në industrinë nxjerrëse në Shqipëri.
- 9- Bërja transparente e kontratave si dhe e rasteve korruptive për kompanitë që punojnë për shfrytëzimin e burimeve natyrore (lumenjtë).
- 10- Të publikohen dhe të informohet publiku mbi format dhe nivelet e kriminalitetit në nivel vendor. Të rritet ndërveprimi i policisë dhe me komunitetin për të parandaluar krimin dhe për të rritur sigurinë në komunitet.
- 11- Të bëhet publike historiku (abuzimet, efienca e ndihmës ekonomike) i familjeve dhe individëve që përfitojnë ndihmë ekonomike, duke u koordinuar me organizatat e shoqërisë civile.
- 12- Të bëhet publike një databazë për zonat e ndotura (ndotje të ajrit, ujit, akustike, vibrociane) si dhe të informohen qytetarët mbi pasojat e ndotjeve në komunitetin ku jetojnë.
- 13- Të hartohet dhe bëhet publike një raport (mujo) mbi veprimtarinë e doganave duke bërë një ndarje midis veprimtarisë së bizneseve dhe asaj të qytetarëve.
- 14- Përfshirja e institucioneve vendore në hartimin dhe zbatimin e Planit të Veprimit. Institucionet vendore duhet të ndërmarrin angazhime për të siguruar transparencë, përfshirje qytetare dhe integritet publik.
- 15- Të bëhen publike korporatat ndërkombëtare që operojnë në Shqipëri si dhe përgjegjësia sociale që ato mbartin për komunitetin ku operojnë. Të bëhet një

koordinim dhe bashkërendim burimesh financiare dhe njerëzore mes institucioneve vendore dhe korporatave për t'iu përgjigjur nevojave të komunitetit

16- Procesi konsultativ për hartimin dhe zbatimin e planit të veprimit duhet të përfshijë të gjithë aktorët në vend veçanërisht OSHC-të që përfaqësojnë komunitetet e marginalizuara dhe të pakicave që veprojnë në të gjithë territorin e vendit.

17- Për të përmbushur një afat shumë të shkurtër për dorëzimin e Planit të Veprimit 7 Maj 2014, Ministria e Administratës Publike dhe Inovacionit duhet të publikojë kalendarin e konsultimit publik, duke detajuar takimet dhe mjetet që do të përdoren për konsultim. Draft Plani i Veprimit duhet të bëhet publik dhe t'iu dërgohet aktorëve të përfshirë për konsultim.

18- Konsultimet duhet të përdorin kanale të shumta komunikimi, duke përfshirë takime, konsultime në internet, konsultimet me komunitetin, takime me organizatat e shoqërisë civile etj.

19- Organizatat e Shoqërisë Civile duhet të organizohen dhe të japin rekomandime gjatë kohëzgjatjes së procesit konsultativ.

20- Plani i Veprimit duhet të përfshijë indikatorët e suksesit, burimet financiare dhe njerëzore si dhe afatet kohore për zbatimin e angazhimeve.

21- Të merren në konsideratë angazhimet e pa plotësuar nga plani 2012-2013;

22- Institucionet publike të gjejnë mënyra për të bërë publike vendimet e tyre me qëllim që këto vendime të shkojnë tek gjithë të interesuarit dhe personat që nuk kanë akses ndaj internetit dhe grupeve të interesuara. Të gjendet mënyra që të gjitha grupet të aksesojnë informacionin nga institucionet publike.

23- Prenotimi Online i takimit për nxjerrjen e certifikatave

24- Publikimi online i titujve të teksteve që do të përzgjidhen nëpër shkolla

25- Biblioteka e dixhitalizuar e arkivës së librit të ndare sipas titujve/çështjeve/autoreve